



KOMUNA E GJILANIT



STRATEGJIA PËR ZHVILLIM
SOCIO-EKONOMIK LOKAL 2017-2021



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Deklaratë për përkufizimin e përgjegjësisë: Përpunimin e këtij publikimi e ka mundësuar populli amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Autorët e botimit janë përgjegjës për përmbajtjen e tij dhe qëndrimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

KOMUNA E GJILANIT



STRATEGJIA PËR ZHVILLIM
SOCIO-EKONOMIK LOKAL 2017-2021

GJILANINFO

BANORË
90.178

QYTETI
54.239

ZONAT RURALE
35.939

SHPENZIMET
KAPITALE
4,201,047

BUXHETI (2017)
22,657,745





SIPËRFAQJA
392 km²

VENDBANIMET E KOMUNËS SË GJILANIT

BILINICË (314), BRESALC (2823), BUKOVIK (80), BURINCË (00), CAPAR (208), CËRNICË (1963), ÇELIK (87), DEMIRAJ (112), DOBËRÇAN (2659), DUNAV (10), GADISH (331), GODEN (29), GUMNISHTË (473), GJILAN (54239), HAXHAJ (206), INATOC (30), KISHNAPOLË (235), KMETOC (691), KRAVARICË (264), KUREXH (394), LIPOVICË (24), LIVOÇ I EPËRM (2551), LIVOÇ I ULËT (3497), LLADOVË (545), LLASHTICË (1624), LLOVCË (169), MALISHEVË (3165), MUÇIBABË (80), NASALË (209), PËRLEPNICË (1944), PIDIQ (342), POGRAXHË (1211), PONESH (967), SELISHTË (179), SLLAKOC I EPËRM (256), SLLAKOC I ULËT (64), SLLUBICË (73), STANÇIQ (8), STUBLINË (79), SHILLOVË (547), SHURDHAN (156), TERZIJAJ (00), UGLAR (1021), VELEKINCË (1602), VËRBICË E KMETOCIT (348), VËRBICË E ZHEGOCIT (584), VRAPÇIQ (290), ZHEGËR (3327), ZHEGOC (168). DY VENDBANIME, BURINCA DHE TERZIJAJT, SIPAS REGJISTRIMIT TË VITIT 2011, NUK KANË ASNJË BANORË.



PËRMBAJTJA

07 **Lista e shkurtesave**

08 **Hyrje**
Vlerësimi i Gjendjes Aktuale

12 **Metodologjia**

13 **Analiza e përparësive, dobësive,
mundësive dhe rreziqeve (SWOT analiza)**

Përparësitë

Dobësitë

Mundësitë

Rreziqet

15 **VIZIONI**

17 **Synimet dhe objektivat strategjike**

20 **Qasja për arritjen e objektivave strategjike**

21 **Plani i aktiviteteve**

19 **Aneksi**

LISTA E SHKURTESAVE

KK	↘ Kuvendi Komunal
MAPL	↘ Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal
SKZH	↘ Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
SZHSEL	↘ Strategjisë për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal
PPP	↘ Partneriteti Publiko Privat
AZHR	↘ Agjensioni për Zhvillim Rajonal
AMF	↘ Ambulancave të Mjekësisë Familjare
QMF	↘ Qendrave të Mjekësisë Familjare
QKMF	↘ Qendre Kryesore e Mjekësisë Familjare
KPSH	↘ Kujdesi Parësor Shëndetësor
KDSH	↘ Kujdesi Dytësor Shëndetësor
SHISH	↘ Shërbimi Informativ Shëndetësor
ASK	↘ Agjencia e Statistikave të Kosovës
DShPIB	↘ Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim
DZHE	↘ Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
BE	↘ Bashkimi Evropian
GIZ	↘ Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (Shoqëria për Bashkëpunim Ndërkombëtar)
TIK	↘ Teknologjia e Informimit dhe Komunikimeve
KEDS	↘ Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike
SWOT	↘ Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet
AKP	↘ Agjencioni Kosovar i Privatizimit
AKM	↘ Agjensioni Kosovarë i Mirëbesimit
KMDK	↘ Menaxhimin e Deponive në Kosovë

HYRJE

Strategjia e Zhvillimit Socio Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit do të jetë një udhërrëfyes për 5 vitet e ardhshme duke planifikuar objektiva të cilat do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimin socio-ekonomik në përgjithësi.

Objektivat kryesore të Komunës së Gjilanit për pesë vitet e ardhshme lidhen kryesisht me zhvillimin ekonomik. Mirëpo, zhvillimi ekonomik varet shumë nga fushat tjera. Ndër prioritetet kryesore është fusha e arsimit, duke krijuar kushte sa më të mira për arsimin e ulët, të mesëm dhe duke krijuar hapësirë edhe për ndërtimin e Kampusit Universitar që do ta shndërronte Komunën e Gjilanit një qytet universitar dhe qendër për komunat përreth si dhe komunat tjera shqiptare nga shtetet fqinje. Një arsim me cilësi dhe infrastrukturë moderne do të krijonte kushte të mira për zhvillim edhe për regjionin e Anamoravës, duke krijuar kuadro të reja konform kërkesës së tregut të punës.

Zhvillimi i industrisë agro-përpunuese do t'i hapë rrugë zhvillimit të bujqësisë duke hapur vende të reja të punës dhe duke stimuluar vetëpunësimin të fermerët përmes subvencioneve dhe rregullimit të infrastrukturës rrugore për qasjen në tokat bujqësore nga Komuna e Gjilanit, granteve nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe nga donacionet të cilat janë në kuadër të programeve të cilat i kemi me donatorët strategjik.

Duke investuar në infrastrukturën fizike, përfshirë rehabilitimin e sistemit të kanalizimit për ujërat e zeza dhe rregullimin e shtratit të dy lumenjve, do të ndikojnë në përmirësimin e ambientit biznesor, duke krijuar kushte më të favorshme për investime në Komunën e Gjilanit. Gjithashtu, duke ofruar shërbime cilësore, dhe kushte më të mira për investitorë do t'i hapim rrugën investimeve përmes Partneritetit Publiko Privat.

Komuna e Gjilanit është qendër kryesore e Anamoravës që pretendon të jetë edhe qendër regjionale ndërkufitare me komunat të cilat janë pjesë e dy shteteve fqinje. E tërë kjo ndërlidhje përmes bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndër-komunal do të mundësojë një zhvillim të rëndësishëm socio-ekonomik duke harmonizuar faktorët natyror me resurset njerëzore për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve, ku do të ndihen mirë e do të bashkëjetojnë në harmoni gjithë grupet shoqërore.

Prioritetet e Strategjisë për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal (SZHSEL) të Komunës së Gjilanit janë në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH) që është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të SZHSEL kemi realizuar një plan të qëndrueshëm, i realizueshëm dhe efektiv i cili është bashkërenduar me faktorët e tjerë që ndikojnë në zhvillimin e komunës.

Prioritetet e përbashkëta me strategjinë kombëtare janë:

- Rritja e qëndrueshme ekonomike për të ulur nivelin e varfërisë, duke siguruar norma vjetore më të larta të rritjes ekonomike.
- Investimet në kapitalin njerëzor do të japin rezultatet e tyre në faza të mëvonshme, por kthimi në investime është i sigurt. Një fuqi punëtore më e aftë do të sigurojë jo vetëm normë më të lartë të rritjes ekonomike, por edhe rritje gjithëpërfshirëse. Kjo është kështu sepse rritja e përfshirjes së fëmijëve në programe arsimore, përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe ndërlidhja më e mirë mes shkollave dhe tregut të punës do t'u mundësojë fëmijëve nga familjet e varfra të fitojnë aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës.
- Tërheqja e investimeve të huaja direkte (IHD) apo investimeve vendore kërkon jo vetëm fuqi punëtore të aftë dhe sundim të ligjit, por edhe rol aktiv të shtetit në adresimin e shtrembërimeve të tregut dhe në ofrimin e shërbimeve lehtësuese dhe favorizuese, sidomos kur bëhet fjalë për sektorët strategjik. Kosova ka interes që të stimulojë kalimin e ekonomisë në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar dhe në prodhime të tregtueshme, sepse vetëm ky hap cilësor do të mund t'i rrisë të ardhurat në ekonomi.
- Rëndësia e infrastrukturës për zhvillimin e një vendi është pothuajse e vetëkuptueshme. Studimet tregojnë se sasia dhe cilësia e infrastrukturës është faktori kryesor që e përcakton gatishmërinë e një biznesi për të investuar në një vend. Një biznes dhe një komunitet nuk mund të ketë sukses nëse nuk ka furnizim të rregullt me energji apo rrugë përmes të cilave mund të plasohen mallrat në treg.

VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE

Gjilani është qendër e mirëfilltë e regjionit të Anamoravës, e cila bashkë me komunat pranë saj, Vitinë, Kllokotin, Parteshin, Novo Bërdën, Kamenicën dhe Ranillugun, por edhe me Preshevën dhe Bujanocin, përbejnë një komunitet prej rreth gjysmë milioni banorësh.

Gjilani është qendër kulturore, ekonomike dhe arsimore e këtij regjioni dhe natyrshëm ai edhe po e luan këtë rol, sidomos me hapjen dhe modernizimin e arterieve komunikuese ndërkufitare me Serbinë dhe Maqedoninë. Si qendër arsimore Gjilani ka një universitet publik dhe dy kolegje private, me profile të ndryshme.

Për këto vite pas luftës Komuna po bën përpjekje maksimale që ta zhvillojë infrastrukturën dhe bazën ekonomike të saj, sepse ende numri i atyre që kërkojnë punë në komunë, është tejet i madh.

Gjilani daton nga viti 1772 dhe është themeluar nga familja e Gjinajve, e cila që nga viti 1737 ka sunduar një pjesë të Kosovës. Sulltani ka njohur pushtetin e kësaj familje. Gjinajt erdhën në Gjilan nga qyteti mesjetar i Artanës (Novobërdë). Si themelues njihet Bahti Beg Gjinolli.

Qyteti shtrihet në një fushëgropë të gjerë, ka kushte të mira për bujqësi dhe njihet si qytet agro-industrial. Janë shënuar përparime të dukshme në ndërtimin e rrjetit të rrugëve, si në zonën urbane, ashtu edhe nëpër fshatra. Janë ndërtuar dhjetëra kilometra ujësjellës e kanalizime në tërë hapësirën e komunës.

Spektori privat konsiston në rreth 2500 ndërmarrje që janë të regjistruara dhe funksionojnë në Gjilan, megjithatë papunësia është e evidente dhe në nivel të lartë. Më shumë se 75% e ndërmarrjeve private të regjistruara janë të angazhuara në aktivitete tregtare, duke punësuar më shumë se 63% të numrit total të të punësuarve në sektorin privat. Vetëm 3.5% e ndërmarrjeve janë të angazhuara në krijimin e vlerës së re – në prodhim.

Deri në vitet e 90-ta, Gjilani kishte një ekonomi relativisht stabile, ajo përbëhej prej Kombinatit të Tekstilit, Kombinatit të Duhanit, Fabrika e Baterive etj. Shumica nga këto fabrika janë privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Sipërfaqja e tokës bujqësore në shfrytëzim sipas regjistrimit të bujqësisë të vitit 2014 në Komunën e Gjilanit është 14624 ha, prej tyre tokë e punueshme (ara) i kemi 5949.88 ha, ndërsa kopshte 46 ha.

Numri i ekonomive bujqësore është 4165 ferma, me grurë i kemi 2970 ha, misër 1043 ha, perime 121 ha. Me pemë frutore i kemi 294 ha, prej tyre mollë 126.80 ha, kumbull 74 ha, vishnje 46 ha, dardhë 13 ha, dredhëz 10 ha, dhe mjedër 13 ha.

Sa i përket blegtorisë, aktualisht janë të evidentuara 3874 krerë lopë në 1561 ekonomi bujqësore, 9340 krerë dele në 98 ekonomi bujqësore si dhe 2225 krerë dhi në 143 ekonomi bujqësore. Gjithashtu në komunën e Gjilanit ka pula vojse rreth 234,000 copë, bletë (koshere) 3490 në 157 ekonomi bujqësore, derra rreth 1390 krerë. Po ashtu janë edhe 2 qumështore, 3 thertore 3 ambulanca veterinare dhe 1 fermë sportive.

Pozita gjeografike i mundëson lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, duke qenë edhe një qendër e rëndësishme në trekëndëshin Gjilan-Preshevë-Kumanovë.

- Lidhja e Komunës së Gjilanit me territorin e Serbisë bëhet përmes:
 - Rrugës magjistrale Gjilan – Bujanoc – Vranjë nëpër grykën e Konqulit, përmes kësaj rruge Kosova ka qasje më të lehtë në boshtin meridional ballkanik nëpër luginën e Moravës ku pastaj lidhet me autostradën Beograd – Shkup.
 - Lidhja tjetër e Komunës së Gjilanit me Serbinë bëhet përmes rrugës regjionale Gjilan - Pasjan - Muçibab – Preshevë dhe del në magjistralen Preshevë – Shkup.
- Lidhja e Komunës së Gjilanit me territorin e Maqedonisë tentohet të bëhet përmes:
 - rrugës regjionale Gjilan - Zhegër – Staniq – Kumanovë dhe del në magjistralen Beograd – Athinë gjegjësisht prek korridorin 8 dhe 10.

Vlen të theksohet që është prezantuar projekti ideor i Autostradës Prishtinë – Gjiilan - Konçul, projekt ky nacional, i cili e lidhë Luginën me korridorin e kombit dhe Gjilanin me korridoret ndërkombëtare. Ky është një projekt gjigant që Lugina lidhet me autostradën e Kombit Prishtinë – Tiranë, ku kjo autostradë do të ndaloj migrimin e Luginës drejt Kosovës, por kjo ndikon edhe për Gjilanin që pritet të sjell përfitime të mëdha për qytetarët e Gjilanit dhe do të ndikoj në zhvillim të hovshëm ekonomik, ku do të zhvillohet edhe Malësia e Zhegocit, Bresalci, Përlepnica dhe fshatrat tjera përreth që i përfshinë autostrada.

Hapja e pikës kufitare Stanqiq - Bellanoc është në fazën finale dhe do të lehtësojë udhëtimin e banorëve Gjilan-Kumanovë.

Arsimi parafillor në Komunën e Gjilanit është i përbërë me 3 çerdhe publike me gjithsej 326 nxënës shqiptarë, ndërsa edhe një çerdhe është në fshatin Shillovë që ka 35 nxënës serb. Arsimi fillor në komunën e Gjilanit përbëhet nga 38 shkolla shqiptare me 13303 shqiptarë, 2 shkolla në gjuhën turke, gjithsej 41 nxënës, 6 shkolla në gjuhën serbe gjithsej 240 nxënës, një paralele në gjuhën rome me 66 nxënës. Në arsimin e mesëm janë 8 shkolla në gjuhën shqipe që zhvillojnë mësimin me gjithsej 5449 nxënës, një paralele në gjuhën turke me 13 nxënës dhe 2 shkolla në gjuhën serbe me 172 nxënës.

Kujdesi shëndetësor në komunën e Gjilanit është veprimtari e organizuar institucionale dhe funksionon në dy sektorë, ai publik si dhe sektori privat.

Sektori publik funksionon në dy nivele:

- Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH) dhe
- Kujdesi dytësor shëndetësor (KDSH)

Sektori privat është i përfaqësuar me klinika dhe ambulanca nga lëmi të ndryshme të mjekësisë specialistike, kabinete diagnostike, laboratorë të biokimisë mjekësore, mjekësi stomatologjike.

Zhvillimi ekonomik lokal është proces në të cilën komunat tentojnë të përmirësojnë dhe zhvillojnë kualitetin e jetës së banorëve të tyre nëpërmjet krijimit të momenteve të reja në mirëqenien ekonomike dhe shoqërore.

Niveli lokal në fushën e zhvillimit socio-ekonomik nuk ka kompetenca të plota që mundet t'i kontribuoj zvogëlimit të papunësisë

përmes tërheqjes së investitorëve, qofshin ata investitorë privat vendorë apo investime të huaja direkte. Mirëpo, pavarësisht mungesës së kompetencave të plota, ka hapësirë për të ndikuar në zhvillimin socio-ekonomik. Komuna ka pak pronë publike që mund të shfrytëzoj, ndërsa prona shoqërore siç dihet administrohet prej AKP-së dhe komunave i zvogëlohet mundësia për të shfrytëzuar pronën shoqërore për dhënie në shfrytëzim apo për shfrytëzim përmes investimeve me PPP.

Në fund të vitit 1981, Kombinati i Gjilanit nënshkruan kontratë me kompaninë angleze "Rothmans Internationals PTC" për prodhimin e cigarës me liçencë të "Dunhill-it". Kjo kontratë ka zgjatuar deri në vitin 1992, kur filluan sanksionet ekonomike ndaj ish-Jugosllavisë.

Gjatë vitit 1981-1989, fabrika e Gjilanit kishte rreth 800 punëtor të rregullt dhe rreth 10,000 fermerë të angazhuar në mbjelljen e duhanit të cilët kishin marrëdhënie kontraktuale. Për vite të tëra për tregun e brendshëm do të prodhohen brendet: Bozhur, Holiday, Oscar etj, si dhe "Dunhill" për eksport për në ish-Bashkimin Sovjetik, ish-Çekoslovaki, Gjermani, Francë, Belgjikë, Turqi e Japoni.

Një prej projekteve i cili është shembull në gjithë Kosovën është edhe krijimi i Kampusit të shkollave të mesme, ku të gjitha shkollat janë në një vend dhe gjatë gjithë orarit të mësimi duhet të qëndrojnë brenda kampusit. Ky projekt është financuar nga partneriteti publiko privat me qëllim të rritjes së sigurisë së nxënësve dhe ngritjes së cilësisë. Kur i shtojmë Universitetin Publik "Kadri Zeka" dhe dy Kolegjet tjera "Gjilani" dhe "Fama" shihet një siguri më e madhe për zhvillimin socio-ekonomik të komunës së Gjilanit përmes kuadrove të shkolluara.

Sfidat me të cilat është ballafaquar sektori publik në vitet e fundit ka qenë mungesa e mjeteve xhiruese, sigurimi i lëndës së parë dhe humbja e tregjeve. Sot 95% e ndërmarrjeve shoqërore janë komercializuar apo edhe privatizuar nga AKM-ja tani AKP.

Ndërsa, sektori privat është ballafaquar me problemet e mungesës së energjisë elektrike, mungesa e kredive jo të favorshme nga bankat komerciale, marrja e kompetencave dhe mungesa e ligjeve dhe rregulloreve komunale. Të gjitha ndërmarrjet e sektorit privat politikën e investimeve e kanë të mbështetur në kapitalin privat - diaspora apo buxheti familjar dhe kreditë komerciale.

METODOLOGJIA

Me rekomandim të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Gjilanit, Kryetari i Komunës ka përcaktuar përfaqësues të gjerë të institucioneve të cilat janë të ndërlidhura me zhvillimin socio-ekonomik të Gjilanit. Përveç, drejtorive të Komunës dhe zyrave janë përfshirë edhe Universiteti "Kadri Zeka", komuniteti i bizneseve, oda ekonomike, Qendra Rajonale e Punësimit, Agjensioni për Zhvillim Rajonal – LINDJE, Shoqëria Civile, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, zyra për barazi gjinore, zyra për komunitete dhe të gjitha partitë politike.

Pas një punëtorie të organizuar nga Instituti Riinvest ku është punuar në grupe me anëtarë të grupit punues për hartimin e strategjisë, janë identifikuar të gjitha sfidat dhe problemet me të cilat përballlet Komuna e Gjilanit për të ndikuar në zhvillimin ekonomik lokal. Grupi punues ka realizuar edhe SWOT analizën së bashku, për ta identifikuar edhe vizionin e komunës.

Identifikimi i projekteve është bërë nga drejtoritë përkatëse të cilat kanë funksionuar si nëngrupe të grupit punues për hartimin e kësaj strategjie. Çdo drejtori ka identifikuar projektet konkrete të cilat mund të ndikojnë në përmbushjen e vizionit i cili është përcaktuar nga grupi punues.

Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga drejtoritë, më pastaj janë filtruar nga drejtoria për zhvillim ekonomik dhe janë plotësuar me informata shtesë për projektet konkrete.



Identifikimi i projekteve është bërë nga drejtoritë përkatëse të cilat kanë funksionuar si nëngrupe të grupit punues për hartimin e kësaj strategjie. Çdo drejtori ka identifikuar projektet konkrete të cilat mund të ndikojnë në përmbushjen e vizionit i cili është përcaktuar nga grupi punues.

ANALIZA E PËRPARËSIVE, DOBËSIVE, MUNDËSIVE DHE RREZIQEVE (SWOT ANALIZA)

Gjatë punëtorisë së organizuar nga Instituti Riinvest ku është punuar në grupe me anëtarë të grupit punues për hartimin e strategjisë, janë identifikuar të gjitha sfidat dhe problemet me të cilat përballlet Komuna e Gjilanit sa i përket Zhvillimit Ekonomik lokal. Grupi punues ka bërë edhe SWOT analizën për ta identifikuar edhe vizionin e Komunës.

Përparësitë

Komuna e Gjilanit ka një pozitë gjeografike të favorshme për të krijuar një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Anamoravës dhe komunave të cilat janë të kufizuara nga shtete fqinje si Maqedonia dhe Serbia. Falë pozitës gjeografike Komuna e Gjilanit njihet edhe si qendër e Anamoravës dhe Regjionit të Lindjes.

Regjioni i Anamoravës përkatësisht, Komuna e Gjilanit ka një traditë shumëvjeçare në industrinë përpunuese. Regjioni i Ana-Moravës njihet si tokë pjellore për kultivimin e kulturave të ndryshme të duhanit, dhe atje nga viti 1945 do të ngritej një pikë e grumbullimit të duhanit nga këto treva e që do të vijojë me krijimin e ndërmarrjes për përpunimin dhe prodhimin e duhanit më 1948. Në vitin 1960 finalizohet fabrika e prodhimit të cigareve e cila vetëm tri vite më pas do të integroheshin të gjitha, ndërmarrjet nga Kosova të cilat do të kultivojnë duhanin dhe do të themelohet si "Kombinati i Duhanit në Gjilan".

Kushtet e volitshme klimatike, boniteti i tokës si dhe përkushtimi dhe mobilizimi i fermerëve, ndikoi në zhvillimin e kësaj dege industriale. Gjatë viteve të '80-ta, janë prodhuar rreth 1.156 tonelata duhan të fermentuar si dhe rreth 1.400 tonelata cigare asortimentesh të ndryshme të kualitetit të lartë.

Përveç, përpunimit të duhanit ka edhe përpunues të profileve të tjera pasi që sipas të dhënave nga regjistri i bujqësisë i vitit

2014, dhe informatave të grumbulluara nga tereni, në territorin e komunës së Gjilanit, me pemë frutore, në kultivim gjysmë intensiv dhe intensiv, janë të mbjella rreth 290 ha.

Komuna e Gjilanit ka potenciale të konsiderueshme natyrore për zhvillimin e turizmit kurativ të banjave. Pavarësisht sipërfaqes së vogël. Ky rajon duke mos e përfshirë Komunën e Kllokotit ka një numër të konsiderueshëm burimesh me rëndësi turistike e gjeotermale, që mund të zhvillohen në të ardhmen. Disa nga burimet kryesore janë: Burimet Hidrotermale në Kmetoc dhe Doberqan, Burimi i ujit termomineral në Pidiq, Burimi i ujit termal në Gumnishtë dhe Burimi i ujit termal në Uglarë.

Në vitet e fundit prioritet i Komunës ka qenë arsimi. Në komunën e Gjilanit është investuar, në infrastrukturën e objekteve, mirëpo edhe në stafin edukativ përmes donatorëve të ndryshëm dhe vetë komunës.

Nga të gjithë sektorët në Komunën e Gjilanit më i favorshmi që mund të ndikoj në zhvillimin socio-ekonomik është sektori i bujqësisë. E përmendëm edhe më lartë që Gjilani ka një traditë në industrinë agro-përpunuese, mirëpo e tëra kjo do të ishte e pamundur nëse nuk ka një potencial bujqësor të cilin e ka Komuna e Gjilanit.

Komuna e Gjilanit ka një moshë të re ku rreth 37% përbëhet nga moshë 0-19. Rreth 27.5% e përbëjnë moshën nga 15-29 vjeç që konsiderohet një potencial i mirë. Sipas regjistrimit të Popullsisë në vitin 2011 Popullsia e moshës 6 deri 29 vjeç që vijnë shkollimin sipas shkollës që vijnë aktualisht, gjinisë, dhe moshës 2011 ka 4 054 në universitet/kolegj (para universitar) si dhe 454 me kolegje / universitet (pasuniversitar). Mirëpo, ky numër është edhe më i madh pasi që pas regjistrimit të popullsisë janë hapur edhe kolegje të reja dhe mundësitë e shkollimit jashtë Gjilanit kanë qenë më të mira.

Dobësitë

Ndër dobësitë kryesore për zhvillimin e komunave është buxheti i pamjaftueshëm. Për të krijuar shërbime të mira dhe cilësore, por edhe infrastrukturë për qytetarë, buxheti i komunave është i pamjaftueshëm.

Përgatitja profesionale jo-adekuate konform nevojave të tregut të punës nënkupton që pavarësisht një popullsie të arsimuar mirë, nuk është në përputhje me nevojat e tregut dhe e harmonizuar me kërkesën e investitorëve të huaj. Kjo ndikon në rritjen e statistikave të papunësisë, pasi që kërkesa për fuqi punëtore nuk përputhet me ofertën, dhe kjo nuk ju kontribuon as bizneseve pasi që kanë mungesë të punëtorëve të profileve të ndryshme.

Komunikimi i pamjaftueshëm me komunitetin e bizneseve ndodh për shkak të mos interesimit të bizneseve se çka mund të ofrojë komuna për bizneset. Kjo ndoshta për shkak të mos përcjelljes së shpalljeve dhe aktiviteteve nga bizneset.

Mungesa e transportit të organizuar urban është një sfidë tjetër e Komunës së Gjilanit e cila do të jetë edhe në pjesën e kësaj strategjie. Mungesa e transportit publik urban, ndikon drejtpërdrejt në aspektin social pasi që shërbimet e taksive janë të shtrenjta për një shtresë të qytetarëve.

Dobësi tjetër e cila ndikon në zhvillimin ekonomik të komunave është edhe çështja e pronës publike. Shumica e pronave tani më janë privatizuar. Një ndër kërkesat kryesore të investitorëve të huaj është siguri i pronës për investime nga ana e komunës.

Mundësitë

Mundësitë në Komunën e Gjilanit janë të favorshme duke u bazuar në infrastrukturën ligjore për zhvillimin e bizneseve të reja dhe ka mundësi edhe më tutje që përmes plotësimit ndryshimit të ligjeve të reja si Ligji për shfrytëzimin e pronës publike dhe ligji për partneritetin publiko privat.

Diaspora është një mundësi e mirë për tërheqjen e investimeve, pasi që një numër i madh i mërgimtarëve në botën e jashtme janë nga Komuna e Gjilanit.

Shumë herë e kemi përmendur edhe bashkëpunimin ndërkufitar, kjo është mundësi e mirë për të përfituar nga grantet e Komisionit Evropian për të ndikuar në zhvillimin e regjionit në aspektin socio-ekonomik.

Gjithashtu në kuadër të ndryshimit të kurikulave të fakulteteve është mundësi e mirë për t'i harmonizuar me kërkesat e tregut. Kjo duhet që të ndryshojë konform kërkesave të tregut. Komuna e Gjilanit ka potencial që të tërheqë investitorët e huaj por edhe vendorë përmes investimeve të Partneritetit Publiko Privat, duke i ofruar investitorit hapësirat publike në favor të shërbimeve më të mira për qytetarët e Gjilanit dhe njëherit duke zbutur papunësinë. Gjithashtu, Komuna e Gjilanit ka mundësi të mira për të tërhequr kapitalin nga jashtë pasi që tani janë disa storie të suksesit të investitorëve të huaj në komunën tonë.

Vitet e fundit Gjilani ka investuar në infrastrukturën fizike duke krijuar edhe kushte të mira për bizneset dhe mundësinë e tërheqjes së investimeve nga jashtë. Vlen të përmendet Autostrada Konçul – Gjilan – Prishtinë e cila do të krijojë mundësi të reja për investime dhe hapjen e tregut të Gjilanit për në Evropë. Gjithashtu, planifikimi i rrugëve në hyrje-dalje të qytetit të Gjilanit i jep një mundësi zhvillimi. Komuna e Gjilanit tani më ka një infrastrukturë të mirë dhe vetëm nevojitet një modernizim.

Rreziqet

Ndikimi negativ i politikave qendrore është një nga rreziqet që mund të jenë pasi që niveli lokal varet nga çdo zhvillim politik nga niveli qendror. Një ndër rreziqet tjera është se Gjilani është zonë aktive sizmike dhe kjo mund ti frikësoj investitorët në fushën e ndërtimitarisë por edhe në fushat tjera.

Mungesa e stabilitetit politik në nivelin qendror tani më është dëshmuar shumë herë që është ndër rreziqet që mund të paraqitet më së shpeshti. Stabiliteti politik është një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në tërheqjen e investimeve të huaja. Si jo të favorshme i shohim edhe proceset integruuese të Kosovës, kufizimin e lëvizjes së lirë të përfaqësuesve nga komuniteti i biznesit por edhe qytetarëve të thjeshtë të cilët kanë nevojë të lëvizin dhe të njihen me përvojat evropiane.

Ekonomia joformale është një rrezik tjetër i cili është luftuar mjaft shumë viteve të fundit, mirëpo ende mbetet një ndër sfidat kryesore. Ndërsa, ekonomia formale gjithnjë e më tepër ka ndikuar në krijimin kushteve më të mira për punëtorët, duke i zbatuar ligjet e punës dhe duke rritur edhe buxhetin e shtetit qoftë në nivelin qendror apo atë komunal.

VIZIONI

Vizioni konceptohet si ideal i cili i ka rrënjët në aspektin human, natyror, gjeografik, ekonomik, social, historik e kulturor të komunës. Ai synon të përmbushë pritshmërinë dhe aspiratat e komunitetit dhe të përcaktojë një drejtim të qartë të zhvillimit socio-ekonomik lokal.

Ndërsa përcaktimi i misionit, ndihmon në vendim-marrjen lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ndryshimet që nevojiten. Në funksion dhe realizimit të vizionit janë caktuar disa synime dhe objektiva të cilat do të elaborohen në vijim.

Për të arritur qëllimet SZHSEL-ja mbështetet në zhvillimin e burimeve të veta natyrore dhe njerëzore. Qëllimet synojnë zhvillim dhe klimë të favorshme biznesore, Zhvillimi i biznesit është nevojë e domosdoshme e vetëqeverisjes lokale në mënyrë që të ulët niveli i papunësisë dhe varfërisë. Objektivi kryesor i Komunës së Gjilanit mbetet orientimi i zhvillimit të tij në linjë me vizionin që ka.



“Gjilani, qendër rajonale urbane dhe universitare, me industri përpunuese të zhvilluar dhe ambient të përshtatshëm për biznesin, duke siguruar shërbime shëndetësore cilësore dhe administratë moderne.”

VIZIONI

Gjilani, qendër rajonale urbane, me industri të zhvilluar përpunuese dhe ambient të përshtatshëm për bizneset me ndikim në përmirësim socio-ekonomik, duke qenë qendër universitare, duke ofruar shërbime shëndetësore cilësore dhe administratë moderne.

SYNIMET



Ndërtimi i kampusit modern të universitetit të Gjilanit deri 2019

Hapja e disa profileve të reja duke u bazuar në nevojat e tregut të punës (në fushën e bujqësisë dhe sportit).



Ngritja e plantacioneve të vishnjës deri në 200 hektarëve të rinj të vishnjës për 3 vitet e ardhshme.

Zhvillimi i industrisë së duhanit përmes subvencionimit të kultivuesve të duhanit.

Avancimi i teknologjisë përpunuese përmes mekanizimit bujqësor.

Rregullimi i infrastrukturës rrugore për qasje në tokat bujqësore

Përkrahja e grave në bujqësi



Krijimi i zonës ekonomike

Transporti urban – 6 linja të reja

Investimi i kopshteve për fëmijë

Palestra e sporteve “Bashkim Selishta – Petriti”

Ndriçimi publik

Stadiumet e futbollit

Funksionalizimi i pjesës praktike të shkollës së mesme profesionale e bujqësisë

Përkrahja e bizneseve

Fuqizimi Ekonomik i Gruas



Ndërtimi i QKMF

Ndërtimi i shtëpisë së kujdesit për të moshuar

Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit për ujërat e zeza.



Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza.

Rregullimi i lumit Mirusha.

Ndërtimi i impiantit për djegien e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë

SYNIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Synimet kryesore të Komunës së Gjilanit janë krijimi i kushteve sa më të mira për qytetarët e Komunës së Gjilanit duke ofruar mundësi për zhvillim ekonomik përmes një arsimit cilësor dhe infrastrukture publike të modernizuar e cila do ta bëjë Gjilanin një qendër regjionale me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët që jetojnë në këtë regjion.

Komuna e Gjilanit përmes kësaj strategjie synon t'i arrij disa 5 synime kryesore të cilat kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik lokal.

- Synim i kësaj strategjie është që Gjilani të jetë **një qendër universitare rajonale**, me qëllim të krijimit të një sistemi të arsimit modern dhe cilësor si në shkollimin para universitar po ashtu edhe në shkollimin universitar.

Për t'u arritur ky synim duhet që të realizohen edhe disa objektiva. Një nga objektivat është përfundimi i kampusit të shkollave të mesme për ti hapur rrugë më pastaj për të ndërtuar kampusin modern të universitetit publik "Kadri Zeka" i cili do të krijoj mundësi më të mira për studentët të cilët do të studiojnë në këtë universitet me drejtime të ndryshme. Me ndërtimin e kampusit universitar lirohet hapësira të shkollat e mesme dhe kjo mundëson edhe ngritjen e cilësisë së arsimit në shkollat e mesme. Për arritjen e këtij objekti, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë mjete financiare për ta financuar projektin "Ndërtimi dhe Renovimi i infrastrukturës së Universitetit të Gjilanit".

Objektiv tjetër është hapja e disa profileve të reja duke u bazuar në nevojat e tregut të punës (në fushën e bujqësisë dhe sportit). Duke u bazuar nga debatet publike të cilat i organizon Komuna e Gjilanit, shqetësimet

më të mëdha të bizneseve janë mungesa e fuqisë profesionale për sektorë dhe fusha të caktuara. Ka mungesë të punëtorëve në fushën e ndërtimtarisë, prodhimit dhe gjithashtu në fushën e shërbimeve të cilat kanë të bëjnë me projektet ndërkombëtare. Ndërsa, nëse thirrëmi në statistikën zyrtare nga qendra e punësimit, përqindja e statistikave të cilët kërkojnë punë është jashtëzakonisht e madhe. Kjo është një disbalancë në mes ofertës dhe kërkesës së punës e cila duhet të rregullohet përmes një hulumtimi që do të identifikojë nevojat e bizneseve dhe ofertën e punëtorëve për tregun e punës. Ky objektivi do të arrihet përmes projektit që ka për qëllim identifikimin dhe analizën e nevojave të tregut të punës.

Objektiv tjetër për të arritur këtë synim është eliminimi i të gjitha ngrohjeve klasike të cilat shfrytëzojnë shkollat dhe instalimi i një sistemi konform normave evropiane të cilat ndikojnë në eficiencën e energjisë dhe zvogëlojnë emetimin e dyoksidit të karbonit në natyrë. Ky objektivi jo vetëm që kontribuon në mbrojtjen e ambientit, mirëpo ndikon edhe në ngritjen e cilësisë së arsimit duke ofruar kushte më të mira për shkollat dhe nxënësit të cilët mësojnë në ato shkolla.

- Synimi i dytë i kësaj strategjie është rikthimi i Gjilanit në një **qendër agro-industriale** e cila më herët ka pasur një traditë në kultivimin e duhanit duke pasur edhe industrinë më të zhvilluar të duhanit në rajon.

Rajoni i Gjilanit ka një traditë edhe në kultivimin e pemëve të ndryshme, sidomos vishnjës e cila më pastaj ka mundësi të përpunohet në industrinë përpunuese e cila aktualisht është relativisht e zhvilluar në regjionin e Gjilanit. Për tu arritur ky objektivi Komuna e Gjilanit ka paraparë që përmes projektit për ngritjen e 75 hektarëve në partneritet me kompaninë "Kalabria"-2017, të subvencionoj fermerët për kultivimin

vimin e vishnjës. Ky projekt do t'i ketë tri faza dhe do të ndikoj në gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe ngritje së mirëqenies së fermerëve duke i ndihmuar komuna përmes partnerit privat që të gjejë tregun e duhur.

Zhvillimi i industrisë së duhanit përmes subvencionimit të kultivuesve të duhanit është një objektivi tjetër që do të ndikoj në mënyrë direkte në arritjen e synimit që Gjilani të jetë qendër agro-përpunuese. Kjo duke i subvencionuar fermerët me rreth 100 hektarëve me fidane të kulturës së duhanit, që përveç ndihmës për fermerët, gjithashtu do të ndikonte në uljen e kostos së lëndës së parë për përpunimin e duhanit.

Objektivi tjetër është avancimi i teknologjisë përpunuese përmes mekanizimit bujqësor duke i subvencionuar fermerët për çdo vit me mekanizëm bujqësor. Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm modern bujqësor, ndikon direkt në cilësinë e produkteve të cilat përdoren në industrinë agro-përpunuese, e që i ndihmon fermerët t'i rrisin kapacitetet e tyre.

Rregullimi i infrastrukturës rrugore për qasje në tokat bujqësore, gjithashtu është një objektivi që duhet të realizohet, pasi që ju ndihmon fermerëve në qasje më të lehtë në arat e tyre dhe ndikon në arritjen e këtij synimi. Objektivi tjetër është edhe përkrahja e grave në bujqësi duke respektuar masat afirmative të parapara sipas ligjit për barazi gjinore.

- Synimi i tretë është **ofrimi i shërbimeve publike përmes partneritetit publiko privat (PPP)**. Përmes këtij synimi komuna ka për qëllim t'i japë mundësi sektorit privat të ofrojë shërbime më të mira dhe më cilësore qytetarëve të Gjilanit duke i ofruar infrastrukturë publike me investime private. Ky synim do të kontribuoj në hapjen e vendeve të reja të punës dhe ndikimin direkt në zhvillim socio-ekonomik të komunës së Gjilanit.

Për ta realizuar këtë synim përmes SZHSEL, janë paraparë disa objektiva, duke filluar me transportin urban, i cili objektivi ka mundësi të realizohet përmes projektit për investime në transportin urban përmes

PPP, në 6 linja të reja. Komuna e Gjilanit ka realizuar një studim të fizibilitetit i cili e përshkruan koston dhe projektin në tërësi. Realizimi i këtij objektivi do të ndikojë në mirëqenien e qytetarëve duke iu mundësuar një qasje të mirë nga një vend në tjetrin me një kosto të përballueshme.

Objektivi që ndikon në arritjen e dy synimeve është Investimi në kopshtet për fëmijë – çerdhe. Ky objektivi ndikon në realizimin e dy synimeve të lartcekura; pra, duke ndërtuar çerdhe të reja përmes PPP ku komuna i ofron partnerit privat tokën, ndërsa partneri privat investon dhe menaxhon me çerdhen për sa vite përcaktohet me studimin e fizibilitetit. Duke i ditur kufizimet (kuotat) e përcaktuara nga MASHT në punësimin e personelit të ri (edukatoreve), kjo mundësi do t'i hapte rrugë punësimeve të reja dhe gjenerimin e të ardhurave nga sektori privat duke ndikuar edhe në plotësimin e nevojave të qytetarëve për ofrimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijët e tyre.

Objektivi tjetër është krijimi i kushteve më të mira për aktivitete rekreative për sportistë. Ky objektivi planifikohet të arrihet përmes dy projekteve. Duke gjetur investitor serioz dhe përmes PPP të investohet në përmirësimin e këtyre kushteve dhe të ipet gjithashtu në menaxhim, për shkak të efikasitetit nga ana e sektorit privat. Komuna nuk ka mundësi financiare të investojë dhe t'u përshtatet standardeve të cilat kërkojnë në lojërat ndërkombëtare dhe kjo do të mundësonte një zhvillim të biznesit privat duke ofruar një përvojë të mirë dhe duke hapur gjithashtu vende të reja të punës.

Komuna e Gjilanit ka një plan për energji të qëndrueshme ku menaxhmenti aktual i saj është zotuar që deri në vitin 2020 të arrijë të reduktojë emetimin e CO2 në natyrë. Kjo ka efekt edhe në zhvillimin ekonomik lokal. Prandaj, këtë objektivi e kemi vendosur në mënyrë që t'i lidhim projektet që kanë mundësi të investohen përmes PPP. Ky objektivi synon të arrihet përmes disa projekteve duke filluar nga ndriçimi publik dhe renovimi konform masave të efijencës së energjisë të objekteve publike dhe shkollave në Komunën e Gjilanit.

Funksionalizimi i pjesës praktike të shkollës së mesme profesionale e bujqësisë është një objektiv tjetër që synohet të realizohet poashtu duke gjetur një investitor privat që të menaxhoj pjesën praktike të pjesës së shkollës bujqësore, e cila nuk po mund të menaxhohet në mënyrën më të duhur për shkak të ligjit të prokurimit publik. Prandaj, ky projekt do t'i mundësonte nxënësve të marrin përvojën e duhur nga sektori privat ku do të mund të punësoheshin si punëtorë sezonal. Objektivi tjetër është edhe përkrahja e bizneseve përmes subvencioneve dhe objektiva e fundit, por jo më pak e rëndësishme është fuqizimi ekonomik i gruas.

- Synim tjetër është përmirësimi i gjendjes aktuale në **shëndetësi si dhe ngritja e mirëqenies sociale.**

Ndërtimi i QKMF-së në një pjesë afër stacionit të autobusëve në Gjilan është njëri nga objektivat kyçe në realizimin e këtij synimi. Përmes kësaj qendre synohet ofrimi i shërbimeve më të mira në shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Projekt tjetër që do të ndikoj në arritjen e këtij objektivi është themelimi dhe ndërtimi i Institutit të Shëndetit Publik të cilin e financon Ministria e Shëndetësisë, ndërsa Komuna është zotuar në sigurimin e lokacionit.

Objektiv tjetër është krijimi i kushteve për të moshuar i cili pretendon të arrihet përmes projektit për ndërtimin e shtëpisë së kujdesit për të moshuar.

- Synimi i fundit është përmirësimi i infrastrukturës fizike.

Ky synim ka disa objektiva si:

- Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit për ujërat e zeza
- Ndërtimi i fabrikës për pastrimin e ujërave të zeza
- Rregullimi i lumit Mirusha
- Ndërtimi i impiantit për djegien e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë

Të gjitha këto objektiva do të ndikojnë në arritjen e synimit për një infrastrukturë moderne duke i realizuar disa nga projektet të cilat janë paraparë në kuadër të kësaj strategjie, si projekte me prioritet.

QASJA PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka krijuar ura të bashkëpunimit të mirë, të sigurtë dhe të gjithanshëm me të gjithë mekanizmat relevant lokal dhe ndërkombëtar të cilat me programet e tyre ndihmojnë zhvillimin ekonomik lokal.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik po koordinon aktivitetet në realizimin e projekteve me komunitetin ndërkombëtar (donatorët e ndryshëm si USAID, GIZ, KfW, BE, ChWB, BERZH, ADA, American Chamber of Commerce in Kosovo, TIKA, OSCE, HELP)

Po ashtu po koordinon aktivitetet e saj edhe në nivelin lokal dhe qendror (ministritë e linjës si Ministrinë e Financave, programi Soft Loan Project, Departamentin e Partneritetit Publiko Privat, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Bujqësisë etj.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe binjakëzimi me qytetet tjera ndërkombëtare do të ndikojë në realizimin e objektivave të SZHSEL. Vlen të përmendet që nga data 15 shkurt 2003, Gjilani është seli e zyrës së Agjencionit për Demokraci Lokale të Këshillit të Evropës, për të qenë anëtare me të drejta të plota në këtë organizatë të fuqishme nga viti 2015, e cila është unike e kësaj natyre që përfaqëson pushtetin lokal, shoqatat, organizatat, akademitë dhe asociacionet që merren me pushtetin lokal në Evropë.

Më 15 tetor në konferencën vjetore të BE-së për një Evropë me energji të qëndrueshme, Komuna e Gjilanit është pranuar në Konventën e kryetarëve të Komunave në Bruksel. Duke u zotuar që të shkojë përtej objektivave të vendosura nga BE për vitin 2020, duke reduktuar emetimin e CO2 për 20 për qind, të paraqesë një Plan Veprimi të Energjisë së Qëndrueshme, të paraqesë një raport të zbatimit të paktën çdo të dytin vit pas dorëzimit të Planit të Veprimit për qëllime të vlerësimit, monitorimit dhe verifikimit, të organizoj Ditet

e Energjisë, sikurse që do të marrë pjesë dhe të kontribuojë në konferencën vjetore të BE-së për kryetarët e Komunave për një Evropë me energji të qëndrueshme.

Për më tepër, Gjilani është binjakëzuar ose ka nënshkruar partneritet me komunat në vijim: Komunën e Kukësit (Shqipëri), Iperit (Belgjikë), Luterbahut (Francë), Yildirim (Turqi), dhe Kumanovën (Maqedoni). Po ashtu Gjilani është edhe anëtare e Asociacionit të Komunave Turke në Botë (TDBB)

Në vitet e fundit Komuna e Gjilanit po bën përpjekje maksimale që ta zhvillojë infrastrukturën dhe bazën ekonomike të saj, sepse ende numri i atyre që kërkojnë punë në komunë, është tejet i madh. Janë shënuar përparime të dukshme në ndërtimin e rrjetit të rrugëve, si në zonën urbane, ashtu edhe nëpër fshatra. Janë ndërtuar dhjetëra kilometra ujësjellës e kanalizime në tërë hapësirën e komunës si dhe është punuar shpejt dhe mirë në zgjerimin e hapësirës shkollore dhe pajisjen e shkollave me inventar të ri.

Është punuar mirë në ndërtimin e zonave të gjelbërta, parkingjeve e trotuareve dhe në mirëmbajtjen e pastrimit të ambientit, kudo në komunë. Ambiciet tona janë që të ndërtojmë parakushte të mira për ardhje të investimeve në komunën e Gjilanit dhe për zhvillim sa më të shpejtë ekonomik të saj. Bashkë me Institucionet Ndërkombëtare (Donatorët) intensivisht është duke u punuar në rregullimin e infrastrukturës moderne si dhe në inkurajimin e investimeve nga brenda dhe jashtë.

PLANI I AKTIVITETEVE

		Viti / Kuartali																			
Nr	Projektet / Aktivitetet	2017				2018				2019				2020				2021			
		Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
1	Rehabilitimi dhe instalimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rregullimi i shtratit të lumit Mirusha dhe Stanishorka																				
2	Programi i Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike																				
3	Vetëdijesimi i grave afariste për rëndësinë dhe kontributin e tyre në zhvillimin e shoqërisë																				
4	Rritja e ndikimit të grave në biznes përmes krijimit të rrjetit joformal avokues të grave në biznes																				
5	Hartimi i strategjisë komunale për fuqizimin e pozitës së gruas në biznes																				
6	Modernizimi i Tregut të Gjellbër																				
7	Palestra e Sporteve - PPP																				
8	Parkingu te ish objekti i Ecohigjienes - PPP																				
9	Rivitalizimi dhe modernizimi i stacionit të Autobusëve në Gjilan - Bashkëfinancim																				
10	Ndërtimi i stacionit të ri të autobusëve sipas PZHU																				
11	Transporti Publik - PPP																				
12	Shkolla e Bujqësisë - PPP																				
13	Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza																				
14	Ndërtimi i impiantit për djegien e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë																				
15	Investimi në zgjerimin e objektit dhe menaxhimit të kompleksit në Stadionin Ndihmës përmes PPP																				
16	Stadioni i qytetit - PPP																				

Nr	Projektet / Aktivitetet	Viti / Kuartali																			
		2017				2018				2019				2020				2021			
		Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
17	Ndërtimi i stadionit të ri sipas PZHU - PPP																				
18	Ndriçimi publik																				
